

VENDIM
Nr.587, datë 5.9.2007

**PËR SHPËRNDARJEN, ME KOEFICIENT PJESOR, TË VLERAVE FINANCIARE
KREDITORËVE TË SHOQËRISË “BENO” SHPK, NË ADMINISTRIM, ME TË
ARDHURAT E REALIZUARA NGA SHITJA E ASETETEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kushtet dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e kreditorëve të shoqërisë “BENO” sh.p.k., në administrim, Lushnjë, sipas koeficientit të kthimit të shumave, të llogaritur si raport i të ardhurave, të realizuara dhe të depozituara, në bankë, nga shitja e aseteve, dhe e shumës së detyrimit të shoqërisë, ndaj kreditorëve.

1.1 Të ardhurat, e realizuara nga shitja e aseteve të shoqërisë “BENO” sh.p.k., në administrim, Lushnjë, dhe të depozituara në Bankën Kombëtare Tregtare, Tiranë janë 20 533 034 (njëzet milionë e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e tridhjetë e katër) lekë.

1.2 Shuma e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse “BENO” sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve është 273 279 182 (dyqind e shtatëdhjetë e tre milionë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

2. Numri i kreditorëve, të cilëve do t’u shpërndahen vlerat financiare, është 10 793 veta.

3. Koeficienti i kthimit të shumave kreditorëve është 7.51 për qind.

4. Shpërndarja e vlerave financiare të kreditorëve do të kryhet në degën e Bankës Kombëtare Tregtare, Lushnjë, sipas marrëveshjes, që do të lidhë Grupi Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë “BENO” sh.p.k., Lushnjë me Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës Kombëtare Tregtare, Tiranë.

5. Për shërbimin e kryerjes së pagesës kreditorëve, Grupi Mbikëqyrës do t’i paguajë degës së Bankës Kombëtare Tregtare, Lushnjë, një komision bankar, në shumën 100 (njëqind) lekë për çdo kreditor, me vlerën e përgjithshme 1 079 300 (një milion e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind) lekë, si dhe shoqërisë “DATECH” sh.p.k., Tiranë, vlerën 50 (pesëdhjetë) lekë për çdo kreditor, gjithsej 539 650 (pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë, për hartimin e listave përfundimtare të kreditorëve, sipas koeficientit përkatës.

6. Shuma 1 618 950 (një milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për vitin 2007, e cila do t’i shtohet Grupit Mbikëqyrës, në planin financiar, zëri “Shpenzime”.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Grupi Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë “BENO” sh.p.k., në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha